

### Çertifikata e origjinës Form A

1. Çertifikata e origjinës Form A duhet të jetë në përputhje me modelin e treguar në Aneks. Përdorimi i gjuhës angleze ose frënge në shënimet në faqen e pasme të çertifikatës nuk është i detyrueshëm. Çertifikatat duhet të plotësohen në gjuhën angleze ose franceze. Nëse plotësohet me dorë, shënimet duhet të bëhen me bojë dhe me gërma të mëdha.

(1) Secila çertifikatë duhet të ketë përmasat  $210 \times 297$  mm; mund të lejohet një tolerancë deri në minus 5 mm ose plus 8 mm në gjatësi dhe në gjerësi. Letra e përdorur duhet të jetë e letër e bardhë për shkrim, brenda përmasave të sipërpërmendura, të mos përmbajë brum mekanik dhe të peshojë jo më pak se  $25 \text{ g/m}^2$ . Ajo duhet të ketë një sfond jeshil model 'guillche' të printuar duke bërë që çdo fallsifikim me mjete mekanike ose kimike të jetë i dukshëm për syrin.

Nëse çertifikata ka disa kopje, vetëm kopja e parë e cila është origjinalja duhet të shtypet me një sfond të gjelbër model-guilloce

2. Secila çertifikatë duhet të ketë një numër serie, të shtypur ose jo, me anë të së cilit mund të identifikohet.

3. Çertifikatat që mbajnë versione të vjetra të shënimeve në faqen e pasme të formularit mundën gjithashtu të përdoren deri sa të mbarojnë rezervat ekzistuese.

1. Goods consigned from (Exporter's business name, address, country)			Reference No <b>GENERALIZED SYSTEM OF PREFERENCES CERTIFICATE OF ORIGIN (Combined declaration and certificate) FORM A</b> Issued in ..... (country)  See notes overleaf		
2. Goods consigned to (Consignee's name, address, country)					
3. Means of transport and route (as far as known)			4. For official use		
5. Item number	6. Marks and numbers of packages	7. Number and kind of packages, description of goods	8. Origin criterion (see Notes overleaf)	9. Gross weight or other quantity	10. Number and date of invoices
<b>11. Certification</b>  It is hereby certified, on the basis of control carried out, that the declaration by the exporter is correct.          ..... Place and date, signature and stamp of certifying authority			<b>12. Declaration by the exporter</b>  The undersigned hereby declares that the above details and statements are correct; that all the goods were produced in  ..... (country)  and that they comply with the origin requirements specified for those goods in the Generalized System of Preferences for goods exported to  ..... (importing country)  ..... Place and date, signature of authorized signatory		

**I. Vende të cilat pranojnë Form A për qëllimin e Sistemit të Përgjithësuar të Preferencave (SPP):**

Australi*	Bashkimi Evropian	Franc	Holland
Bjellrosi	Austri	Gjermani	Poloni
Kanada	Belgjik	Greqi	Portugali
Island	Bullgari	Hungari	Rumani
Japoni	Kroaci	Irland	Slovaki
Zelanda e Re**	Qipro	Itali	Sloveni
Norvegji	Republika Çeke	Letoni	Spanj
Federata Ruse	Danimark	Lituani	Suedi
Zvicër duke përfshirë Lihtenshtejn***	Estoni	Luksemburg	Mbretëri e Bashkuar
Turqi	Finland	Malt	
Shtetet e Bashkuara të Amerikës****			

*Detaje të plota të kushteve që mbulojnë pranimin e SPP në këto vende gjenden pranë autoriteteve të caktuara në vendet eksportuese përfituese të preferencave ose nga autoritetet doganore të vendeve dhënëse të preferencave të renditura më sipër. Një informacion i tillë gjendet gjithashtu pranë Sekretariatit të UNCTAD.*

*Nën skemat SPP vendet të cilat i kanë dhënë preferenca Shqipërisë si një vend përfitues i preferencave janë: Australia, Japonia, Zelanda e Re, Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe vendet e Bashkimit Doganor ndërmjet Bjellorusisë, Kazakistanit dhe Rusisë\*\*\*\*\*.*

**II. Kushtet e përgjithshme**

Për t'u kualifikuar për preferencë, mallrat duhet që:

- të jenë brenda përshkrimit të produkteve të kualifikueshme për preferencë në vendin e destinacionit. Përshkrimi i dhënë në formular duhet të jetë mjaftueshmërisht i detajuar për të mundësuar identifikimin e produkteve nga zyrtari doganor i cili ekzaminon mallrat;
- të jenë në përputhje me rregullat e origjinës së vendit të destinacionit. Çdo artikull në një dërgesë duhet të kualifikohet më vete sipas rregullave të saj, dhe
- të jenë përputhje me kushtet e dërgesës të specifikuar nga vendi i destinacionit. Në përgjithësi produktet duhet të dërgohen nga vendi eksportues në vendin e destinacionit, por shumica e vendeve preferencë-dhënëse pranojnë kalimin nëpërmjet vendeve të ndërmjetme që u nënshtrohen kushteve të veçanta (Për Australinë, dërgesa direkte nuk është e nevojshme)

**III. Plotësime që duhen bërë në Kutinë 8**

Produktet që përfitojnë preferencë duhet të jenë tërësisht të përfutuara në përputhje me rregullat e vendit të destinacionit, ose të punuara apo të përpunuara mjaftueshëm për të përmbushur kërkesat e rregullave të origjinës të atij vendi

- Produkte tërësisht të përfutuara: për eksport në të gjitha vendet e listuara në Seksionin I, shënoni gërmën "P" në kutinë 8 (Për Australinë dhe Zelandën e Re Kutia 8 mund të lihet bosh)
  - Produkte të punuara apo të përpunuara mjaftueshëm për eksport në vendet e specifikuar më poshtë, Kutina 8 duhet të plotësohet si më poshtë:
- Shtete e Bashkuara të Amerikës: për dërgesat e një vendi të vetëm, në kutinë 8 fut shkronjë "Y", për dërgesat nga shoqëri të njohura të vendeve, shënoni shkronjën "Z", e ndjekur nga shuma e kostos ose vlerës së materialeve të vendit si dhe kostoja direkte e përpunimit, e shprehur në përqindjen e çmimit të fabrikës/ex-works të produkteve të eksportuara; (shembull "Y" 35% ose "Z" 35%).
  - Kanada: për produktet që përmbushin kriteret e origjinës nga punimi ose përpunimi në më shumë se një vend i kualifikueshëm më pak i zhvilluar, në kutinë 8 fut shkronjën "G", në rast të kundërt shkronjën "F"  
Island, Bashkimi Evropian, Japonia, Norvegjia, Zvicra duke përfshirë Liteshtejnin dhe Turqinë; në kutinë 8 fut shkronjën "W" të pasuar nga Përshkrimi i Harmonizuar i Mallrave dhe Sistemi i kodifikuar (Sistemi i Harmonizuar) dhënë në nivelin 4 shifror të produkteve të eksportuara (shembull "W" 96.18).
  - Federata Ruse: për produktet të cilat përfshijnë vlerën e shtuar në eksportimin në vendin preferencë- marrës, në kutinë 8 shëno gërmën "Y" të pasuar nga vlera e materialeve të importuara dhe përbërësve të shprehur si një përqindje të çmimit FOB të produkteve të eksportuara (shembull "Y" 45%); për produktet e përfituara në një vend marrës preferencash dhe të punuara apo të përpunuara në një ose më shumë nga këto vende, shënohet "Pk".
  - Australia dhe Zelanda e Re: plotësimi i kutisë 8 nuk kërkohet. Është e mjaftueshme që deklarata të bëhet në mënyrën e duhur në Kutinë 12.

\*Për Australinë, kërkesa kryesore është deklarata e eksportuesit në faturën tregtare normale. Formulari A, i shoqëruar nga fatura tregtare normale, është një alternativë e pranueshme, por nuk kërkohet certifikim zyrtar.

\*\* Nuk kërkohet certifikim zyrtar

\*\*\* Principata e Liteshtejnin formon, në përputhje me Traktatin e 29 mars 1923, ka bashkim doganor me Zvicrën

\*\*\*\*Shtetet e Bashkuara nuk kërkojnë Formularin A të SPP. Një deklaratë që parashtron të gjitha informacionet përkatëse të hollësishme në lidhje me prodhimin ose fabrikimin e mallrave konsiderohet e mjaftueshme, vetëm nëse kërkohet nga Taksambledhësi Doganori i zonës

\*\*\*\*\*Lista e Vendeve dhuruese të preferencave dhe e vendeve përfituese të preferencave është subjekt ndryshimi